



Referencat ndaj certifikimit të dhënë nga EQSC

EQSC

European Quality & Safety Control

Management System Certification Body

Ky dokument përmbledh të drejtat dhe detyrimet e klientëve të certifikuar nga EQSC për sa i përket përdorimit të referencave ndaj certifikimit të dhënë nga EQSC.

1.1 Referencat ndaj certifikimit të EQSC

Klientët e certifikuar nga EQSC mund të përdorin referencat (tekst, logo, etj.) ndaj certifikimit të dhënë nga EQSC, vetëm për atë qëllim certifikimi të marrë dhe jo në të gjithë aktivitetin e kompanisë së tyre, në mënyrë që të nënkuptohet se i gjithë aktiviteti është i certifikuar nga EQSC.

➔ E drejta e përdorimit

Referencat e certifikimit, siç përcaktohen në këtë procedurë, mund të përdoren vetëm nga Klientët e certifikuar (certifikimi i të cilëve vazhdon të jetë aktiv) si dhe të cilët kanë rënë dakord paraprakisht me FP.310_9 Termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimit.

Referencat e certifikimit dhënë nga EQSC nuk do të përdoren në produkt apo në paketimin e produktit, e parë nga konsumatori ose në çfarëdoq mënyre tjetër, që mund të interpretohet si paraqitje e konformitetit të produktit.

EQSC nuk lejon markat e tij të përdoren në teste laboratorike, raporte kalibrimi apo inspektimi, sepse të tilla

raporte konsiderohen si produkte në kontekstin e kësaj procedure.

Klientët e certifikuar do të përdorin referencat ndaj certifikimit siç përcaktohen nga EQSC, në:

- Materiale promocionale (broshura, fletëpalosje, etj.);
- Panaire, takime, etj.
- Në automjete apo struktura të përhershme (siç janë ndërtesat),
- ose kudo tjetër ku gjykojnë të vlefshëm përdorimin e tyre.

Për aq sa një përdorim i tillë ka të bëjë me aktivitete, të tilla si zhvillimin, prodhimin, shpërndarjen e produkteve/shërbimeve për të cilat certifikimi i sistemit të menaxhimit është dhënë.

Kur klienti ka më shumë se një filial, atëherë përdorimi i referencave të certifikimit do të bëhet vetëm nga ato filiale të certifikuara.

➔ Referenca në formë të shkruar

Referenca në formë të shkruar (tekst) për sa i përket certifikimit të dhënë nga EQSC duhet të ketë këtë njëzën prej këtyre përmbajtje teksti:

- **“Sistem i Certifikuar Menaxhimi” nga EQSC, Shqipëri, ose**
- **Kompania xxx përdor Sistem Menaxhimi të certifikuar EQSC (ISO xxx/HACCP, etj.) për prodhimin/përpunimin e xxx produkteve/shërbimeve.**


Në rast se përdoret njëri nga shënimet e mësipërme, është e detyrueshme të përdoret edhe teksti:

- **Nr 00xx** – që i referohet numrit unik të certifikatës.

Shembull paraqitje mund të jenë:



Shembull 1 Kur përdoret bashkë me Logon e EQSC



Shembull 2 Kur nuk pa logon e EQSC

Përdorimi i logos së EQSC në Shembullin 1, jepet vetëm në rastet kur Menaxhim i lartë i EQSC, gjykon që nuk ka mundësi për keqpërdorimin e saj.

Lloji i shkrimit, madhësia dhe ngjyra, duhet të jenë të tilla që të vihen re menjëherë, të qarta, dhe i përdorur në vendin e duhur, për të përjashtuar çdo përdorim që mund të çojë në keqkuptim apo keqinterpretim të certifikimit të dhënë.

➔ Referenca në formë vizive (markë)

Aktualisht EQSC nuk përcakton një markë e cila do të përdoret nga klientët e certifikuar.

Në rast se një markë e tillë do të përcaktohet, mënyra, forma dhe rregullat e përdorimit të saj do të përcaktohen në FP.340_1 Udhëzues përdorimi i markës së certifikimit.

1.2 Certifikata e konformitetit

Certifikata e lëshuar nga EQSC për të dëshmuar konformitetin e Sistemit të menaxhimit të klientit është pronë e EQSC dhe do të përdoret nga klienti vetëm nëse certifikimi i dhënë është ende i vlefshëm. Në të kundërt, kur certifikimi është tërhequr, anuluar, etj. certifikata duhet

të kthehet te EQSC dhe ndalohet përdorimi i mëtejshëm i saj.

Certifikata origjinale e lëshuar nga EQSC si dhe kopje të saj mund të përdoret për arsye promocionale në panaire, takime, etj., në aplikime për procese të ndryshme tenderimi, konkurse, etj.

Nuk lejohet përdorimi i kopjeve të kësaj certifikate, të cilat mund të çojnë në keqkuptim apo keqinterpretim të certifikimit të dhënë. Gjithashtu, kopjet e këtij dokumenti që përdoren nga klienti duhet ose të jenë kontrolluar dhe miratuar nga EQSC (nëpërmjet vendosjes së vulës së kompanisë në dokumentin kopje) ose të jenë të noterizuara. Kopjet e tjera të cilat mund të përdoren sikur janë origjinale, janë të ndaluara të përdoren.

Shkeljet e përcaktimeve të mësipërme do të çojnë pezullim ose tërheqje të menjëhershme të certifikimit të dhënë.

1.3 Logo e EQSC

Logo e kompanisë EQSC është pronë e EQSC dhe nuk lejohet të përdoret si referencë ndaj certifikimit të dhënë nga EQSC.

Në rast se një klient i certifikuar dhe me certifikimin ende të vlefshëm, do të kërkojë të përdorë këtë logo në materiale promocionale, etj. (siç është paraqitur në pikën 1.2 më lart) do të marrë leje me shkrim përpara se të fillojë procesin e publikimit të materialeve (printimit) do të marrë leje me shkrim për përdorimin e saj.

Çdo klient i interesuar, do të kontaktojë me zyrën qendrore të EQSC. EQSC nuk përcakton një formë specifike për këtë leje. Administratori i EQSC do të jetë autoriteti i cili është përgjegjës për dhënien e autorizimit të përdorimit të referencave ndaj certifikimit të dhënë, dhe për mbikëqyrjen e vazhdueshme të përdorimit të këtyre referencave.

➔ Rregullat e përdorimit të logos së EQSC

EQSC rregullon përdorimin e logos së tij nga klientët e certifikuar, për elementët e mëposhtëm:

- a) Madhësia e logos. Madhësia e logos së përdorur në materialet promocionale apo të tjera, të klientit, duhet të vendoset nga EQSC, rast pas rasti në varësi të materialit në të cilin do të përdoret logo. Për këtë arsye klienti duhet të dërgojë pranë EQSC një kopje të materialit të skicuar, për miratim paraprak.
- b) Font: Segoe Ui.
- c) Ngjyra: Logo mund përdoret me ngjyrat siç është në origjinal **CMYK**: C-0; M-100; Y-67; K-40 ose **RGB**: R-153, G-0, B-51. Në rast se ngjyrat dhe skicimi i materialit në të cilin do të vendoset kërkon logo një ngjyrëshe, në varësi të vendosjes dhe sfondit në material mund të zgjidhet ngjyra e duhur. Në çdo rast lloji i shkrimit (EQSC) duhet të jetë i njëjtë.
- d) Vendndodhja në material. Logo e EQSC do të përdoret në një vend të dukshëm, pa shkaktuar konkurrencë me logon apo shenjat e vetë klientit. Gjithsesi në rast se vendoset të përdoret logo e EQSC ajo duhet të jetë qartësisht e dukshme, në çdo rast.

3.5 Mbikëqyrja e përdorimit

Mbikëqyrja e përdorimit të referencave të certifikimit dhe logos së EQSC do të kryhet:

- Gjatë auditimeve nga EQSC,
- Nga informacioni i marrë nga komentet e konsumatorëve, furnitorëve, etj. të klientëve të certifikuar,

- Nga plotësimi i detyrimit të miratimit paraprak të përdorimit të referencave nga klienti.

Administratori i EQSC është autoriteti përgjegjës për këtë mbikëqyrje dhe masat e marra në rast të shkeljeve.

3.6 Masat në rast keqpërdorimi

Përgjegjësia e përdorimit të referencave të certifikimit, logos së EQSC apo certifikatës së lëshuar, do të jetë e klientit të certifikuar.

Në rast keqpërdorimi të tyre, Administratori i EQSC së bashku me personelin përkatës, merr masat si më poshtë në varësi të masës së keqpërdorimit:

- Njoftimin e klientit me shkrim për marrjen e masave të menjëhershme korrigjuese (anulimi i të gjithë materialeve të publikuara dhe tërheqjen nga tregu të të gjithë produkteve me referencat e gabuara).

Në rastin kur verifikohet se klienti nuk ka marrë masat e duhura korrigjuese, EQSC do të ndërmarrë pezullimin e certifikimit. Në rast se edhe pas mbarimit të afatit të pezullimit, nuk janë ndërmarrë masat e duhura, EQSC fillon procedurën e tërheqjes së certifikimit dhe publikon në faqen e tij të internetit listën e përditësuar të klientëve.

Në rastet kur klientit edhe pse i është tërhequr certifikimi vazhdon të keqpërdorë referencat ndaj certifikimit, logon apo certifikatën e lëshuar, EQSC do të:

- Paraqesë çështjen për ndjekje pranë Gjykatës së Tiranës.
- Sanksionojë klientin në vlerë financiare.